



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Procesverbal

Nga mbledhja e punës së Kuvendit të FPPK-së e mbajtur me 09.03.2026, në Hotel Sirius në Prishtinë me fillim nga ora 19:30 .

Në mbledhje ishin prezent përfaqësues vijues të klubeve:

1. Alban Hoxha: Kpp Ahmet Hoxha
2. Ridvan Hashani: Kpp Ahmet Hoxha F
3. Ardian Lamaxhema: Kpp Ahmet Hoxha MK
4. Veton Gota: Kpp Bashkimi(me vonesë 5 min)
5. Jeton Oruqi: Kpp Dardania
6. Skender Zeqiri: Kpp Drita F
7. Gani Pireva: Kpp Drita M
8. Sabit Gashi: Kpp Dukagjini
9. Tahir Hamzaj: Kpp Fitorja Klinë
10. Ylli Maloku: Kpp Gani Maloku
11. Adhurim Bllaca: Kpp Gjilani F
12. Agron Brestrovci: Kpp Gjilani M
13. Argjent Ferati: Kpp Hasan Prishtina
14. Arton Haxhijaj: Kpp Istogu
15. Burim Kuçi: Kpp Juniku
16. Jahja Tërmkolli: Kpp Kosovari
17. Remzi Shala: Kpp Kvpp Prizreni
18. Rifat Rifati: Kpp Lidhja e Prizrenit
19. Besim Hajdari: Kpp Liria
20. Sheremet Hoti: Kpp Llapusha
21. Qamil Vishaj: Kpp Maestro
22. Gani Zeneli: Kpp Peja F
23. Nita Baymak: Kpp Ponte Prizren(me vonesë 5min)
24. Besart Domaniku: Kpp Prishtina
25. Nehat Çitaku: Kpp Shkolla
26. Erroll Karabaxhak: Kpp Shkolla Prizreni
27. Kreshnik Dacaj: Kpp Shqiponjat e zeza
28. Fitim Krasniqi: Kpp TTC Ferizaj
29. Bahri Limolli: Kpp Ulpiana
30. Hekuran Podrimçaku: Kpp Vitomirica
31. Petrit Drenica: Kpp Vushtrria
32. Leoresa Imeri: Kpp Vushtrria F

Klubi pa të drejtë vote::

1. Berkan Bajmak:Kpp Kalaja Pz (me vonesë 5min)

Munguan klubet:

1. Arben Selmani: Kpp Artana
2. Kpp Priping
3. Kpp Prishtina F
4. Kpp Shpresa
5. Kpp Skenderaj

Pjesëmarrës tjerë: Fadil Luta-Sekretar I përgjithshëm, Alban Azemi-anetar i bordit, Albana Krasniqi: zyrtare për administrate dhe financa, Rrita Mulaj-zyrtare për media dhe marketing, Leart Sveqila - Ekspert për Hartimin e Politikave dhe Projekteve Zhvillimore, Samire Jupolli-fotografe.

Kuvendi u monitorua nga përfaqësuesi i MRS Fidan Shatri, ndërsa munguan përfaqësues nga Koku.

Rendi i ditës

i miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FPPK-së

1. Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit;
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit nga viti 2025;
4. Raporti i regjistrimit për vitin kalendarik 2026;
5. Raporti i Punës së FPPK-së për vitin 2025;
6. Raporti Financiar i FPPK-së për vitin 2025;
7. Raporti i Auditorit për vitin 2024
8. Propozimi i buxhetit të FPPK-së për vitin 2026;
9. Propozimi i Kalendarit të FPPK-së për vitin 2026;
10. Propozimi i shortit të garave ekipore për vitin 2026
11. Plani Strategjik 2026-2030
12. Propozimet për ndryshime në aktet Normative
 - a. Ndryshimet në Statut
 - b. Rregullorja e Regjistrimit
 - c. Rregullorja e Sistemit të Garave
13. Temat e propozuara nga klubet për diskutim në Kuvend:
 - 12.1. KPP Ahmet Hoxha – propozimet

14. Raporti i drejtorit të përfaqësueses për vitin 2025
15. Shqyrtimi i vlerësimit të më të mirëve për vitin 2025
16. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit me 22/02/2026 dhe 01/03/2026
17. Raportet e WTT-së për vitin 2026
18. Raporti i Grupit Punues.
19. Nominimi dhe zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit të propozuar nga Kryetari i FPPK-së.
20. Raporti i Komisionit për Asete,
21. Raporti nga Komiteti i Gjyqtarëve
22. Lista e kontratave me sponsorë
23. Të ndryshme

Kryetari i FPPK-së, pasi i përshëndeti dhe u uroi mirëseardhje të gjithë të pranishmëve, kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm që të bëhet verifikimi i prezencës së delegatëve. Pas konstatimit të ekzistimit të kuorumit në Kuvend, u njoftua se të pranishëm ishin 32 pjesëmarrës me të drejtë vote, nga gjithsej 37 përfaqësues të klubeve me të drejtë vote.

Pika 1.

Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;

Kryetari propozoi që procesverbalin ta mbajë Zyrtarja për Administratë dhe Financa, Albanë Krasniqi, propozim i cili u aprovua njëzëri.

Para se të kalohej në pikat e rendit të ditës, Kryetari shfrytëzoi rastin të falënderojë Kryeshefin e Agjencisë për Sport, Fidan Shatri, për prezencën dhe përkushtimin e tij të vazhdueshëm ndaj zhvillimit të sportit. Ai gjithashtu shprehu shpresën që në këtë takim të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Komitetit Olimpik, në mënyrë që bashkëpunimi institucional të jetë sa më i plotë dhe konstruktiv.

Në këtë kontekst, Kryetari përcolli edhe një mesazh nga Presidentja e Federatës Botërore të Pingpongut, Petra Sörling, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me federatën tonë.

Petra Sörling përshëndeti pjesëmarrësit e Kuvendit dhe vlerësoi zhvillimin e Federatës së Pingpongut të Kosovës, duke theksuar sistemin e garave vendore, ekipet kombëtare dhe pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare. Ajo nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit në komunitetin ndërkombëtar të pingpongut dhe përkushtimin për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sporti. Në fund, ajo uroi federatën për suksese sa më të mëdha.

Pika 2.

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit.

Kryetari: E dëgjuam mesazhin e Presidentes, të cilën e falënderojmë për përshëndetjen dhe mbështetjen e saj. Me këtë rast, kalojmë në pikat e rendit të ditës, të cilat janë dërguar

paraprakisht edhe përmes emailit. Gjatë kësaj periudhe ka pasur disa propozime shtesë për përfshirje në rendin e ditës. Të gjitha këto propozime janë shqyrtuar dhe janë përfshirë. Në total, janë 22 pika të parapara për këtë mbledhje. Kryetari theksoi se kohëzgjatja e mbledhjes mund të jetë pak më e gjatë dhe kërkoi mirëkuptimin e të pranishmëve. Ai i ftoi pjesëmarrësit që gjatë diskutimeve të jenë konstruktivë dhe të drejtpërdrejtë. A ka ndonjë nga të pranishmit ndonjë propozim shtesë lidhur me pikat e rendit të ditës?

Sheremet Hoti: Kam një vërejtje, nëse lejohet. Procesverbalet dhe rendin e ditës na i keni dërguar vetëm disa orë para Kuvendit, dhe kjo nuk më duket në rregull. Po ashtu, procesverbalet nuk janë përpiluar në mënyrë të detajuar, por janë shumë të shkurtra.

Kryetari: Procesverbali zakonisht dërgohet pasi të mbyllet Kuvendi. Kjo është hera e tretë që po mblidhemi. Dërgimi paraprak i procesverbaleve ka qenë kërkesë e z. Nehat. Në mbledhjet e kaluara nuk arritëm të kalojmë rendin e ditës, prandaj nuk u zhvillua mbledhja e plotë e Kuvendit. Prej sot fillojmë ta mbajmë Kuvendin dhe më pas do ta pranoni procesverbalin.

Nehat Çitaku: Kërkoj që edhe një herë të bëhet verifikimi i përfaqësuesve të klubeve, meqenëse disa kanë ardhur me vonesë.

Përfaqësuesit e klubeve që janë zgjedhur në Kuvendin e kaluar si komision verifikues – Ardian Lamaxhema, Nita Baymak dhe Alban Hoxha, së bashku me Sekretarin – bënë verifikimin dhe numërimin e të pranishmëve. Nga gjithsej 37 klube, ishin prezent 32 klube me të drejtë vote, ndërsa 1 klub ishte prezent pa të drejtë vote. U konstatua se ekziston kuorum për vazhdim të Kuvendit.

Kryetari: Meqenëse kemi kuorum, po e hedhim në votim rendin e ditës. Ju njoftoj edhe një herë për rregullat e votimit: janë vota për, kundër dhe abstenim. Abstenimi konsiderohet si votë kundër, megjithatë ekziston mundësia e abstenimit, por duhet të keni parasysh se llogaritet si votë kundër. Prandaj, ju lutem t'i keni parasysh këto rregulla gjatë votimit. Rendi i ditës ju është dërguar dhe e keni pranuar. A jemi dakord me këtë rend dite?

Nehat Çitaku: Nuk jemi dakord me rendin e ditës në formën e paraqitur. Kam një propozim që pika 12, “Propozimet për ndryshime në aktet Normative”, të vendoset si një nga pikat e para të rendit të ditës, duke pasur parasysh rëndësinë e saj.

Kryetari: Në rregull. Pika 12, propozohet të vendoset si pika e parë e rendit të ditës. Pastaj me shumicë të votave, vetëm një kundër u mor ky:

Vendim

I. Aprovohet rendi i ditës

Pika 12.

Propozimet për ndryshime në aktet Normative

- a. Ndryshimet në Statut**
- b. Rregullorja e Regjistrimit**
- c. Rregullorja e Sistemit të Garave**

Kryetari: Pika e parë e rendit të ditës: ndryshimet në aktet normative. Akti i parë që propozohet për ndryshim është Statuti i Federatës së Pingpongut të Kosovës, akti i dytë është Rregullorja e regjistrimit, ndërsa akti i tretë është Rregullorja e sistemit të garave. Dokumentet ju janë dërguar dhe shpresoj që i keni lexuar paraprakisht.

a. Ndryshimet në Statut

Qëllimi i ndryshimeve statutorore është rritja e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së Kryetarit, Bordit Ekzekutiv dhe stafit administrativ, duke e bërë të detyrueshme përgatitjen e planeve vjetore të punës dhe raportimin e rregullt para Bordit dhe Kuvendit si organ mbikëqyrës. Ndryshimet e tjera përfshijnë: organizimin e strukturave organizative përmes një rregulloreje, përfshirjen e pozitës së ndihmës të drejtorit të përfaqësuesve të Kosovës dhe kompetencën e kryetarit për të propozuar dy anëtarë, me miratimin e Bordit Ekzekutiv.

A ka ndonjë vërejtje ose propozim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?

Nehat Çitaku: Procesi i hartimit të statutit dhe rregulloreve nuk ka qenë i rregullt dhe transparent. Draftet e këtyre dokumenteve, të përgatitura nga komisioni përkatës, duhej t'u dërgoheshin klubeve më herët, në mënyrë që ato të kishin mundësi të japin vërejtjet dhe propozimet e tyre. Megjithatë, dokumentet janë dërguar vetëm shtatë ditë para mbajtjes së Kuvendit, gjë që nuk është praktikë e zakonshme dhe nuk përputhet me parimet demokratike. Andaj, unë mendoj dhe sugjeroj që ndryshimi i statutit dhe i këtyre rregulloreve sot të diskutohet vetëm, ndërsa vendimi të miratohet në një Kuvend tjetër.

Fidan Shatri: Federatat posedojnë licencat që u jepen nga Ministria. Ministria i mbikëqyr federatat për të siguruar që aktivitetet e tyre janë në përputhje me rregullat dhe ligjet. Në rast se federatat shkelin statutin ose rregullat e licencës, Ministria ka të drejtë t'u tërheqë licencën.

Besart Domaniku: Kjo pikë është shumë e rëndësishme dhe ndikueshme. Sugjeroj që për këtë pikë të na jepet një kohë për debat, në mënyrë që të zgjidhim bashkarisht këto probleme dhe të kalojmë te pikat tjera për të mirën e të rinjve. Unë shoh që ekzistojnë shumë interesa personale, prandaj është e nevojshme që të kemi një diskutim të hapur dhe shoqëror, për të tejkaluar këto çështje dhe për të ecur tutje.

Kryetari: Janë mbajtur dy punëtori zhvillimore, në të cilat këto çështje janë diskutuar dhe trajtuar në mënyrë të detajuar. Propozimet janë dërguar me kohë, drafti i statutit është përgatitur dhe vërejtjet që janë pranuar janë inkorporuar.

Ajo që dua të theksoj për shqetësimin e Besartit: ndoshta do të ishte më mirë të diskutohej, por drafti është përgatitur dhe janë shpenzuar mjete financiare për realizimin e tij. E hedhim në votim; nëse nuk kalon, nuk kemi problem që në një mbledhje të ardhshme të përgatitet sërish statuti dhe të hidhet edhe një herë në votim. 13 për, 16kunder dhe 1 abstenim kuvendi mori këtë:

Vendim

I. Nuk aprovohen ndryshimet në Statut

b. Rregullorja e Regjistrimit

Sekretari: Siç e keni parë të gjithë, kjo rregullore është vazhdimësi e dy punëtorive që kemi zhvilluar dhe e pyetjeve të ndryshme që i kemi dërguar klubeve. Ne kemi bërë ndryshimet në Rregulloren e regjistrimit sipas kërkesave të klubeve, me qëllim lehtësimin e procesit të regjistrimit:

- Tani është e mundur regjistrimi i trajnerëve që të marrin pjesë si sportiest për klubin e tij në garat ekipore.
- Është mundësuar ndryshimi i regjistrimit të anëtarëve nga njëra pozitë në pozitën tjetër brenda të njëjtit vit.
- Procesi i regjistrimit është thjeshtuar: dokumentet e shumëta që klubet dorëzonin çdo vit tani mjafton t'i dorëzojnë në dy dokumente për të kompletuar procesin. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm: më parë kërkohej aplikacion i veçantë për secilin sportist. Tani është paraqitur një listë e vetme me të gjithë sportistët dhe nënshkrimet e tyre, e cila mund të dërgohet edhe me email, duke përfunduar procesin e regjistrimit për klubin.

Pas diskutimeve me 18 për, 3 kunder dhe 6 abstenime kuvendi mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet rregullorja e regjistrimit

c. Rregullorja e Sistemit të Garave

Sekretari: Kjo rregullore ka më pak ndryshime; ndryshimet kryesore lidhen kryesisht me emërimin e neneve me të pjesëmarrjen e sportistëve në vetëm një kategori, si dhe mënyra e formimit të ligave në rast të shtimit të numrit të klubeve.

Ndryshimet kryesore janë:

1. Për turnetë që organizohen gjatë vitit 2026, do të ketë më shumë kategori në të njëjtën ditë. Megjithatë, andaj një sportist nuk mund të marrë pjesë në të njëjtën ditë më shumë se një kategori.

2. Formimi i ligave ishte i paqartë më parë. Tani, neni 24 përcakton qartë mënyrën e formimit të ligave, numrin e klubeve në të njëjtën ligë dhe mënyrën e formimit të ligave rajonale. Do i kemi këto liga: Superligën, Ligën e Parë, Ligën e Dytë dhe Ligat Regjionale, duke shmangur krijimin e ligave shtesë me pak ekipe. Andaj Këto janë ndryshimet kryesore në rregulloren e sistemit të garave.

Pas diskutimeve me 26 për, 0 kundër dhe 3 abstenim kuvendi mori këtë:

Vendim

- I. Aprovohet rregullorja e sistemit të garave

Pika 3.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit nga viti 2025

Kryetari: Kërkesa e Nehatit është marrë parasysh. Procesverbali është ndarë në dy pjesë, pjesa e parë deri në kohën kur Kuvendin e udhëhoqi Nehati në kuvendin e kaluar, e pastaj pjesa tjetër e procesverbalit që kam udhëhequr unë.

Pas diskutimeve unanimisht u mor ky:

Vendim

- I. Aprovohet procesverbali i kuvendit të vitit 2025

Pika 4

Raporti i regjistrimit për vitin kalendarik 2026

Sekretari: Pas përfundimit të afatit na kanë ardhur dy kërkesa nga KPP Sharri dhe Kpp Shkollat Ahmet Hoxha femra për t'u regjistruar. Dokumentet e tyre janë të kompletuara, mirëpo, duke qenë se afati ka kaluar, kjo është një e drejtë që i takon Kuvendit nëse i aprovojme edhe këta dy klube me i shtu në kuader të atij raportit që e kemi.

Pas diskutimeve kuvendi unanimisht mori këtë:

Vendim

- I. Aprovohet raporti i komisionit të regjistrimit
- II. Aprovohet lejimi i regjistrimit të klubeve KPP Sharri dhe Kpp Shkollat Ahmet Hoxha femra pasi të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm

Pika 5,6,7

- 5. Raporti i Punës së FPPK-së për vitin 2025;**
- 6. Raporti Financiar i FPPK-së për vitin 2025;**
- 7. Raporti i Auditorit për vitin 2024**

Kryetari: A keni ndokush naj vërejtje ose naj propozim për këto 3 pika,?

Nehat Çitaku: Unë mendoj që ky raport i punës është shumë dëshirore, nuk e pasqyron realitetin. Ne duhet të reflektojmë, kemi mungesa në shumë lami.

Pas diskutimeve kuvendi unanimisht mori këtë:

Vendim

- I. Aprovohet me vërejtje Raporti i Punës së FPPK-së për vitin 2025;
- II. Aprovohet Raporti Financiar i FPPK-së për vitin 2025;
- III. Aprovohet Raporti i Auditorit për vitin 2024;

Pika 8

Propozimi i buxhetit të FPPK-së për vitin 2026

Kryetari theksoi se edhe propozim buxhetin për vitin 2026 e keni pranuar me kohë, andaj nëse nuk ka ndonjë vrejte të aprovojmë edhe buxhetin.

Nehat Çitaku: Në buxhet ishte parashikuar rroga e zëvendës drejtorit, e cila duhet të hiqet pasi statuti nuk kaloi, si dhe të kthehen mjetet në mënyrë retroactive. Propozimi im është që fondi i zhvillimit të trefishohet dhe të investohet te të rinjtë, duke parashikuar të paktën dy bursa për ta. Të kemi një buxhet për pjesëmarrje në aktivitete të WTT-së, siç p.sh Kroacia e kish të parapare pjesëmarrjen në WTT në Kosovë.

Kryetari: Jo vetëm dy, por për vitin 2026 janë planifikuar 7 bursa gjithsej, asnjehere nuk ka qenë më shumë bursista në federatë.

Fitim Krasniqi: Unë mendoj se bursat duhet të jepen sipas ranglistës vjetore: për lojtaret e parë, të dytë dhe të tretë. Kjo do t'i stimulojë ata të marrin pjesë në gara dhe të angazhohen në stërvitje. Pjesa tjetër e bursës mund të jepet si shpërblim në fund të vitit, pasi të përfundojë krejt kampionati.

Propozimi im është që vlera totale për seniorët të jetë 15,600 euro:

- 1,000 euro për vendin e parë,
- 500 euro për vendin e dytë,
- për secilën kategori të tjera të ketë shpërblime të vogla, nga 20–50 euro.

Kështu, të gjitha kategoritë përfshihen dhe në fund, gjatë ceremonisë së laureatëve, do të bëhet shpërblimi final.

Fidan Shatri: Në kuadër të strategjise shtetërore unë sugjeroj që ju të bëni një projekt të mire të aplikoni dhe ne ja u pranojmë.

Kryetari: Atëherë, ishin tre propozime kryesore:

1. Trefishimi i fondit të zhvillimit, gjë që paraqet një problem të vogël.
2. Rritja e numrit të bursave, por për momentin mbeten 7, me mundësi rishikimi në të ardhmen. Kjo është çështje që i takon sekretarit të menaxhojë.
3. Pozita e ndihmës-drejtorit të përfaqësueses – propozohet heqja dhe diskutimi për kthimin e mjete, por nuk mund të ju merret në mënyrë retroactive mjete pasi ato tashmë janë kryer.

Kryetari: Ju lutem të mendoni nëse ka nevojë për pozitën e ndihmësit të përfaqësueses. Natyrisht, kushdo që emërohet, fëmijët kanë nevojë për mbështetje, sepse ne po dojme me e dërgu federatën sa më përpara.

Petrit Drenica: Më duket se problemi më i madh është titulli, jo personi.

Kryetari: Nëse ky është shqetësimi, mund të ndryshojmë titullin, por edhe personin, por nëse ka propozime të tjera lidhur me krijimin e një pozite shtesë me pagesë, e cila do të mbante përgjegjësi për përfaqësueset. Ai sqaroi se personi në këtë pozitë do të kishte detyra të qarta, do të ishte përgjegjës për rezultatet e punës. Gjithashtu theksoi se emërimi dhe shkarkimi i këtij personi do të bëhej në bazë të performancës.

Ai shtroi pyetjen nëse të pranishmit janë të pajtimit që të ekzistojë një person i dytë që do të merret me përfaqësuesen qoftë me titullin ndihmës, asistent apo trajner.

Sheremet Hoti: Propozoi që të definohej edhe kriteret e përzgjedhjes për pozitën e ndihmës drejtorit ose trajnerit.

Kryetari: Po Sheremet, në këtë pozitë duhet të përzgjidhet një person meritues që ka dhënë dhe do të jap kontribut për federatën.

Pas diskutimeve unanimisht u mor ky

Vendim

- I. Aprovohet projekt buxheti për vitin 2025 me rritje 10% të fondit të zhvillimit
 - a. Ndryshimin e titullit të ndihmës drejtorit në trajner për meshkuj dhe trajner për femra
- II. Në fazën e rishikimit të buxhetit të shihet mundësia e shtimit të një buxheti për pjesëmarrje në aktivitete të wtt-së.

Pika 9

Propozimi i Kalendarit të FPPK-së për vitin 2026

Kryetari: Njoftoi të pranishmit se është marrë vendim për reduktimin e kalendarit të aktiviteteve, pasi që gjatë vitit të kaluar kanë qenë gjithsej 103 aktivitete, ndërsa për këtë vit numri i tyre është zvogëluar në 70 aktivitete.

Nehat Çitaku: Theksoi se sa i përket pikës për kalendarin e garave, ai duhet të harmonizohet me buxhetin. Gjithashtu propozoi që në kalendar të përfshihet edhe WTT, në mënyrë që të dihet saktësisht dhe me kohë se cilët lojtarë do të marrin pjesë, në mënyrë që ata të përgatiten në mënyrë adekuate.

Fitim Krasniqi: Propozoi që garat të mos organizohen për grupmosha të ndryshme në të njëjtën ditë.

Veton Gota: Propozoi që turneu “Lidhja e Prizrenit” të jetë turne poentues.

Kryetari: Propozoi që kalendari i garave të miratohet në parim, ndërsa brenda katër (4) ditësh komisioni përkatës të dalë me një propozim përfundimtar, në koordinim me klubet organizatore, nëse duan të jetë turne poentues apo jo.

Pas diskutimeve unanimisht u mor ky:

Vendim

- I. Aprovohet kalendari i garave në parim
- II. Komisioni i garave do të shoh mundësinë e ndarjes së aktiviteteve në ditë të veçanta si dhe turneve tjerë poentues.

Pika 10

Shorti i garave ekipore për vitin 2026

Kryetari: Njoftoi të pranishmit se shorti është hedhur dhe është ndarë, dhe se i njëjti u është dërguar të gjithëve përmes emailit. Ai theksoi se, meqenëse nuk ka pasur ndonjë vërejtje apo propozim nga të pranishmit lidhur me këtë çështje e qesim në votim. Andaj unanimisht kuvendi mori këtë:

. Vendim

- I. Aprovohet shorti i garave për vitin 2026

Pika 11

Plani Strategjik 2026-2030

Kryetari: Informoi të pranishmit se Plani Strategjik është përgatitur nga Learti, të cilin e falënderoi për angazhimin dhe punën e bërë. Ai theksoi se për këtë pikë nuk ka pasur vërejtje nga askush.

Nehat Çitaku: Theksoi se Plani Strategjik, në aspektin profesional, duhet të reflektohet edhe në buxhet. Ai vlerësoi se buxheti i viteve 2025 dhe 2026 nuk ka dallim të madh dhe se plani i veprimit duhet të përcaktojë më qartë përgjegjësitë, afatet dhe koston e aktiviteteve. Megjithatë, ai shtoi se plani mund të aprovohet për shkak të kërkesave të ministrisë dhe pikëve që sjell në procesin e kategorizimit, edhe pse ende nuk është i detajuar plotësisht.

Leart Sveqlla: Sqaroi se plani është prezantuar edhe në punëtorinë e kaluar dhe janë marrë disa vërejtje, kryesisht lidhur me prioritetet mes cilësisë dhe masovizimit, të cilat janë përmirësuar. Ai theksoi se plani është një dokument dinamik dhe se do të përgatitet edhe një përmbledhje që do të prezantohet online. Gjithashtu shtoi se disa çështje të planit të veprimit varen nga kompetencat që duhet të përcaktohen në Statut

Nehat Çitaku Pyeti lidhur me çështjen e koston.

Leart Sveqlla: Sqaroi se kostoja nuk mund të planifikohet saktësisht deri në vitin 2030, pasi buxheti në planin strategjik është dinamik dhe përcaktohet më qartë pasi Kuvendi miraton buxhetin, i cili më pas inkorporohet në planin e veprimit.

Agron Brestovci: Shtoi se është e rëndësishme të parashihet edhe një pjesë për aktivitete të paplanifikuara, pasi nuk mund të dihet paraprakisht se çfarë mund të ndodhë në vitet e ardhshme.

Pas diskutimeve kuvendi unanimisht mori këtë:

Vendim

- I. Aprovohet plani strategjik

Pika 13

Temat e propozuara nga klubet për diskutim në Kuvend:

KPP Ahmet Hoxha – propozimet

Kryetari: Për këtë pikë vetëm se i diskutuam propozimet, kalojmë tek pika tjetër.

Pikat

14.Raporti i drejtorit të përfaqësueses për vitin 2025:

17.Raportet e WTT-së për vitin 2026

18.Raporti i Grupit Punues.

20.Raporti i Komisionit për Asete,

21.Raporti nga Komiteti i Gjyqtarëve

Kryetari: Propozoi që këto pika të votohen në paketë, pasi të gjitha janë raporte.

Ridvan Hashani: Shprehu disa vërejtje, veçanërisht për Komitetin e Gjyqtarëve dhe Komisionerin e Garave. Ai theksoi se gjatë vitit të kaluar kishte kërkuar që proceset e zhvillimit të garave t'u dërgohen anëtarëve, por kjo nuk është bërë.

Nehat Çitaku: Theksoi se nuk është e nevojshme që proceset të dërgohen, por ato duhet të publikohen në web faqe

Kryetari: Shprehu shqetësim edhe për disa çështje të tjera dhe propozoi që këto tema të diskutohen më gjerësisht në një takim tjetër, përfshirë edhe çështjen e laureatëve, si dhe punën e trajnerëve dhe gjyqtarëve.

Nehat Çitaku: Para votimit kërkoi informatë se sa tavolina gjenden në depo.

Sekretari: Informoi se janë edhe 4 tavolina në depo që ende nuk janë shpërndarë dhe se gjatë vitit 2025 komisioni nuk është mbledhur për të bërë shpërndarjen e pajisjeve.

Kryetari: Theksoi se çështja e tavolinave është diskutuar shumë dhe propozoi që klubet t'i ridërgojnë kërkesat e tyre, ndërsa komisioni të bëjë vlerësimin dhe më pas të merret vendimi për shpërndarje. Ai shtoi se aktualisht komisioni për asetë nuk ka kryesues dhe kërkoi propozime për këtë pozitë.

Pas diskutimeve, u vendos që Fitim Krasniqi të emërohet kryesues i Komisionit për Asete. Gjithashtu u dakordua që klubet t'i ridërgojnë kërkesat e tyre, ndërsa komisioni të bëjë verifikimin dhe më pas të realizohet shpërndarja e tavolinave.

Eroll Karabaxhaku: Shprehu një shqetësim lidhur me një rast në garat e zhvilluara në Pejë më 07.09.2025, ku sipas tij në një moment është futur në lojë një lojtar tjetër në vend të lojtarit të paraqitur. Ai theksoi se posedon edhe dëshmi fotografike dhe se më shqetësues për të është fakti i mundshëm i mashtrimit nga një arbiter.

Kryetari: Theksoi se rasti është shqetësues dhe propozoi që të shqyrtohet nga Komisioni i Garave.

Eroll Karabaxhaku: Sqaroi se atë ditë ka qenë arbiter dhe ka pasur dyshime, të cilat më vonë i ka verifikuar duke identifikuar lojtarin që kishte luajtur me një emër tjetër për klubin Shqiponjat e Pejës, me numër 226. Ai gjithashtu shprehu shqetësim për mosfunksionimin e duhur të Komisionit të Garave dhe Komisionit Disiplinor.

Kryetari: Theksoi se çështja do të adresohet dhe se do të thirren Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Gjyqtarëve për të shqyrtuar rastin. Ai kërkoi një afat 30-ditor, sipas procedurave administrative, për shqyrtimin e plotë të rastit.

Besim Hajdari: Shtoi se ky nuk është rasti i vetëm dhe se ka pasur edhe raste të tjera të ngjashme, ku në mungesë të lojtarëve janë futur në lojë persona të tjerë vetëm kanë ndërruar fanellën.

Kryetari: Theksoi se të gjitha këto shqetësime do të përmbledhen dhe do t'i dërgohen Komisionit të Gjyqtarëve dhe Komisionit Disiplinor, të cilët duhet të raportojnë për rastet dhe vendimet e marra, pas së cilave çështja do të rishqyrtohet.

Pas diskutimeve kuvendi mori unanimisht këtë:

Vendim

- I. Aprovohen keto raporte:
 - a. Raporti i drejtorit të përfaqësueses për vitin 2025;
 - b. Raportet e WTT-së për vitin 2025
 - c. Raporti i Grupit Punues.
 - d. Raporti i Komisionit për Asete,
 - e. Raporti nga Komiteti i Gjyqtarëve

Pika 15

Shqetësimet e klubeve lidhur me vlerësimin e më të mirëve për vitin 2025

Besim Hajdari: Shprehu shqetësim lidhur me shpalljen e laureatëve, duke theksuar se asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që të ndërhyhet në klub. Ai theksoi se këtë vit është kërkuar që klubet të regjistrohen si tërësi, me ekipe përbërëse për vajza dhe djem, ndërsa në shpalljen e laureatëve rezultatet janë ndarë veçmas për meshkuj dhe për femra. Sipas tij, kjo krijon paqartësi në mënyrën e vlerësimit të rezultateve të klubeve.

Kryetari: Sqaroi se problemi qëndron në mangësitë e rregullores aktuale. Ai theksoi se, meqenëse garat zhvillohen në kategori të veçanta për meshkuj dhe femra, duhet të përcaktohet qartë në rregullore nëse rezultatet do të mbledhen veçmas apo së bashku. Ai shtoi se, sapo të arrihet dakordimi për këtë çështje, do të organizohet një takim për të punuar në përmirësimin e rregullores për laureatët. Si përfundim a jeni që të miratohet shqetësimi i klubeve për laureatet dhe të ulët dhe të punohet me rregullore urgjent.

Pika 16

Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit me 22/02/2026 dhe 01/03/2026

Nehat Çitaku: Propozoi që procesverbalet nga dy mbledhjet e Kuvendit të dërgohen me të gjitha shënimet dhe diskutimet e bëra.

Kryetari: Theksoi se të gjitha procesverbalet do të dërgohen sapo të përfundojë edhe ky Kuvend.

Pas diskutimeve me 16 për e 11 kundër, kuvendi mori këtë

Vendim

- I. Aprovohen dy procesverbalet e kuvendit me vërejtje

Pika 19

Nominimi dhe zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit të propozuar nga Kryetari i FPPK-së.

Kryetari: Theksoi se, sipas Statutit, kryetari i Federatës së Pingpongut ka të drejtë të propozojë dy anëtarë të Bordit Ekzekutiv. Ai sqaroi se pas zgjedhjes së tij në muajin janar kishte propozuar dy persona që kanë dhënë kontribut në pingpong, Besim Hajdari dhe Qamil Vishaj. Më tej njoftoi se gjatë kësaj periudhe Besim Hajdari ka dhënë dorëheqje, ndërsa Qamil Vishaj, i cili ka qenë anëtar i bordit dhe nënkryetar, ka vazhduar të kryejë detyrën e tij.

Ai theksoi se sot janë mbledhur për të diskutuar propozimin e kryetarit dhe se propozimi i tij është që Qamil Vishaj, i cili me profesion është kontabilist dhe trajner i certifikuar, të vazhdojë si anëtar i Bordit Ekzekutiv. Kryetari vlerësoi kontributin e tij gjatë periudhës njëvjeçare, veçanërisht në organizimin e WTT Youth dhe Feeder, dhe kërkoi përkrahjen e anëtarëve të federatës për këtë propozim. Ai shtoi se propozimin e dytë do ta paraqesë në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Nehat Çitaku: Theksoi se edhe propozimi për anëtarin e dytë duhet të paraqitet në këtë mbledhje.

Kryetari: Propozoi përsëri Besim Hajdari, në rast se ai e pranon.

Besim Hajdari: Deklaroi se për momentin nuk është i gatshëm ta pranojë këtë detyrë dhe se mund të shqyrtohet në të ardhmen.

Kryetari: Theksoi se për momentin nuk ka propozim tjetër dhe njoftoi se propozimin e dytë do ta paraqesë në mbledhjen e radhës së Bordit Ekzekutiv, i cili më pas do të paraqitet për miratim në Kuvend, sipas procedurave statutore.

Pas diskutimeve me 13 vota për dhe 16 vota kundër kuvendi mori këtë:

Vendim

- I. Nuk aprovohet propozimi i kryetarit që Qamil Vishaj të jetë anëtar i bordit ekzekutiv.

Pika 22

Lista e kontratave me sponsorë

Kryetari: Pyeti të pranishmit nëse e kanë pranuar listën dhe nëse ka ndonjë vërejtje. Ai theksoi se, që nga marrja e detyrës në janar, janë zhvilluar shumë konsultime dhe takime me sponsorë, por ka qenë e vështirë të sigurohen sponsorë të rinj, edhe pse janë bërë përpjekje dhe diskutime gjatë gjithë vitit. Ai gjithashtu informoi se, në momentin kur e ka marrë detyrën në janar të vitit 2025, Federata e Pingpongut ka qenë në borxh në vlerën 77,995 euro. Megjithatë, gjatë vitit 2025, përmes organizimit të garave WTT dhe me mbështetjen e institucioneve, si dhe falë punës dhe përkushtimit të federatës, është arritur të krijohet një buxhet prej 523,427.16 euro, duke e bërë atë buxhetin më të lartë në historinë e Federatës së Pingpongut, si dhe duke arritur njëkohësisht edhe shlyerjen e borxhit.

Pas diskutimeve kuvendi mori unanimisht këtë:

Vendim

- I. Aprovohet lista e sponzorëve për vitin 2025

Pika 23

Të ndryshme

Kryetari: Informoi se për këtë pikë nuk ka pasur propozime apo diskutime nga të pranishmit, dhe meqenëse kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës deshta të ju falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen, kontributin dhe diskutimet gjatë Kuvendit, shihemi në mbledhjet e ardhshme.





Mbledhja e Kuvendit përfundoi në ora 00:30.

Kuvendi i rregullit 09 03 2026 Lista e delegatëve

Klubet me të drejtë vote

N r	EMRI I KLUBIT	KOMUNA	DELEGATI	nr personal	Nënshkrimi
1	Kpp Ahmet Hoxha	Ferizaj	Alban Hoxha	1030661784	
2	Kpp Ahmet Hoxha F	Ferizaj	Ridvan Hashani	1011623421	
3	Kpp Ahmet Hoxha MK	Ferizaj	Ardian Lamaxhema	1003437341	
4	Kpp Artana	Novobërda	Arben Selmani	1012260349	
5	Kpp Bashkimi	Prizren	Veton Gota	1230398450	
6	Kpp Dardania	Prishtina	Jeton Oruçi	1500993584	
7	Kpp Drita F	Gjilan	Skender Zeqiri	1011892376	
8	Kpp Drita M	Gjilan	Gani Pireva	1012887104	
9	Kpp Dukagjini	Klinë	Sabit Gashi	1013478674	
10	Kpp Fitorja Klinë	Klinë	Tahir Hamzaj	1002508296	
11	Kpp Gani Maloku	Ferizaj	Yli Maloku	1004479960	
12	Kpp Gjilani F	Gjilan	Adhurim Bilaca	1002991132	
13	Kpp Gjilani M	Gjilan	Agron Brestovci	2002355127	
14	Kpp Hasan Prishtina	Vushtrri	Argjend Ferati	1231146403	
15	Kpp Istogu	Istog	Artan Haxhijaj	1003641046	
16	Kpp Juniku	Junik	Burim Kuçi	1173532730	
17	Kpp Kosovari	Fushëkosovë	Jahja Tërmkolli	1013538073	
18	Kpp KVPP Prizreni	Prizren	Remzi Shala	1002693930	
19	Kpp Lidhja e Prizrenit	Prizren	Rifat Rifati	1002690922	
20	Kpp Liria	Prizren	Besim Hajdari	1016489456	
21	Kpp Llapusha	Malishevë	Sheremet Hoti	1030852024	
22	Kpp Maestro	Peja	Qamil Vishaj	1009287082	
23	Kpp Peja F 2020	Peja	Gani Zeneli	2013434517	
24	Kpp Ponte Prizren	Prizren	Nita Baymak	1173417515	
25	Kpp Priping	Prishtina			
26	Kpp Prishtina	Prishtina	Besart Domani	1002319520	
27	Kpp Prishtina F	Prishtina			

Kuvendi i rregullt 09 03 2026 Lista e delegatëve




28	Kpp Shkolla	Prishtina	Nehat Çitaku	1004111989	
29	Kpp Shkolla Prizreni	Prizren	Eroll Karabaxhak	1016417030	
30	Kpp Shpresa	Skenderaj			
31	Kpp Shqiponjat e zezë	Deçan	Kreshnik Dacaj	1008765797	
32	Kpp Skenderaj	Skenderaj		1004825353	
33	Kpp TTC Frizaj	Ferizaj	Fitim Krasniqi	1172478286	
34	Kpp Ulpiana	Lipjan	Bahri Limolli	1015809228	
35	Kpp Vitomirica 2024	Peje	Hekuran Podrimçaku	1003287269	
36	Kpp Vushtrria	Vushtrri	Petrit Drenica	1172782708	
37	Kpp Vushtrria F	Vushtrri	Leoresa Imeri	1248151426	

32

Klubet pa të drejtë vote

N r	EMRI I KLUBIT	KOMUNA	DELEGAT	Nënshkrimi
1	Kpp Kalaja Pz	Prizren	Berkan Bajmak	
2	Kpp Lipjani 2015	Lipjan		

Pjesëmarrës tjerë

N r	Emri	Pozita	Instituti	Nënshkrimi
1	Alban Azem	A. Boshit	FPPK	
2	Samir Jupi	Foto	FPPK	
3	Leart Suterka	Exp Doe strah	FPPK	
4	Alban Krasniqi	Financa	FPPK	
5	Arta Mujaj	Marketing	FPPK	
6				
7				
8				
9				
10				
11				